


# DORACAK

---

PROGRAMI I REHABIILITIMIT TË  
BAZUAR NË BASHKËSI (RBB)


QASJA BIO-PSIKO-SOCIALE



# PËRMBAJTJA

---

|                                                     |   |
|-----------------------------------------------------|---|
| Lista e shkurtesave.....                            | 2 |
| Hyrje.....                                          | 3 |
| Qëllimi.....                                        | 4 |
| Programi i Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi..... | 5 |
| Qasja Bio-Psiko-Sociale.....                        | 6 |



# LISTA E SHKURTESAVE

---

PAK – Persona me aftësi të kufizuara

OJQ – Organizata Jo Qeveritare

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

OPAK – Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara

RBB – Rehabilitimi i Bazuar në Bashkësi

BPS – Bio-Psiko-Social

OBSH – Organizata Botërore e Shëndetësisë

ONP – Organizata Ndërkombëtare e Punës

UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

# HYRJE


---

HANDIKOS është organizata më e vjetër në vend, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983, e themeluar me qëllimin kryesor për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Sot, HANDIKOS është shoqata më me ndikim në fushën e aftësisë së kufizuar, gëzon shtrirjen më të gjerë në Kosovë dhe vazhdon të mbrojë në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës.

HANDIKOS vazhdon të mbetet një ndër ofruesit kryesor të shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në Kosovë, përmes 14 Qendrave dhe 12 zyrave lokale, të cilat veprojnë në vend që nga viti 1996. Aktualisht këto qendra ofrojnë shërbime me bazë në komunitet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, duke synuar qasje gjithëpërfshirëse në kopshte, shkolla, treg të punës dhe shoqëri.

Paralelisht, HANDIKOS është i fokusuar edhe në avancimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke promovuar diversitetin dhe të drejta të barabarta për të gjithë.

A collection of 10 black silhouettes of people in various active and joyful poses, set against a white background. The silhouettes include: a person in a dynamic pose with arms raised; a person in a wheelchair with arms raised; a person jumping with arms raised; a person in a wheelchair being assisted by another person; two people jumping with arms raised; a person in a wheelchair being pushed by another person; two people holding a horizontal bar; a person in a dynamic pose with arms raised; and two people in a dynamic pose with arms raised.



# QËLLIMI I KËTIJ DORACAKU

---

Ky doracak është hartuar me qëllim të promovimit të programit të Qendrave të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, dhe Qasjes Bio-Psiko-Sociale, të cilin Qendrat e implementojnë, në mënyrë që të lehtësohet informimin e marrësve të shërbimeve/komunitetit, institucioneve shëndetësore, arsimore dhe të mirëqenies sociale dhe të inkurajojë bashkëpunimin mes tyre, sipas parimeve të qasjes Bio-Psiko-Sociale.






# Programi i Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi

---

Programi i Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi është strategji në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të bashkësisë, që synon rehabilitimin, mundësitë e barabarta dhe përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, me qëllim të mbështetjes së tyre drejt jetesës së pavarur. Ky program njihet nga organizatat e mëdha ndërkombëtare, si OBSH, ONP, UNESCO, ndërsa mbështetet edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe UNICEF.

Rehabilitimi i Bazuar në Bashkësi paraqet një program të zhvillimit të komunitetit, që është multidiciplinar dhe adreson të gjitha fushat që janë themelore në përmirësimin e kualitetit të jetës së personave me aftësi të kufizuara. Duke qenë se funksionon në bazë të parimeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, RBB promovon dhe lehtëson shëndetin, mirëqenien dhe pjesëmarrjen e plotë të persona me aftësi të kufizuara në fushën e edukimit, në jetën sociale, kulturore, ekonomike dhe politike të komunitetit të tyre dhe zhvillohet përmes përpjekjeve të kombinuara të vetë personave me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre dhe komunitetit.

Qendrat e RBB-së orientohen nga parimi i respektimit të të drejtave njerëzore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe me një sjellje të natyrës pjesëmarrëse ku mendimi i përfituesve të shërbimit kërkohet dhe merret në konsideratë, pavarësisht faktorëve social që i rrethojnë ata.




*“Programi i Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi shërben për të gjithë komunitetin, sepse një mjedis i qasshëm dhe i bazuar në të drejta, bën jetën më të lehtë për secilin prej nesh”.*



# QASJA BIO-PSIKO-SOCIALE

---

Qasja Bio-Psiko-Sociale është model i cili bazohet në parimin se për të kuptuar shëndetin, aftësinë e kufizuar dhe ofrimin e kujdesit/shërbimeve, duhet të konsiderohen faktorët biologjik, psikologjik, shoqëror dhe ndërveprimet e tyre komplekse. Për më tepër, Modeli BPS është i bazuar në principet e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionalitetit – KNF, të cilat vendosin personin në qendër duke u bazuar në nevojat, shkathtësitë dhe afinitetet e individit. Principe të njëjta janë të përfshira edhe në draft Ligjin Gjithëpërfshirës [1]




Modeli Bio-Psiko-Social në mënyrë sistematike konsideron faktorët biologjik (shëndeti fizik; aftësi e kufizuar; dobësitë gjenetike); psikologjik (shëndeti emocional; vetë-vlerësimi; shkathtësitë përballuese; shkathtësitë sociale) dhe ata social (rrethanat dhe relacionet familjare; shkolla; puna; të afërmit; bashkëmoshatarët) në të kuptuarit e shëndetit dhe funksionimit të tij, përderisa fokus mbetet vetë personi dhe nevojat e tij. Në këtë mënyrë, përmes kësaj qasje ofruesit e shërbimeve lidhin dhe analizojnë të gjithë faktorët potencial që ndikojnë në fusha të caktuara të funksionimit të fëmijës/rriturit me aftësi të kufizuara, dhe planifikojnë intervenimet e nevojshme.

Ky model ofron mundësi të vlerësimit holistik të nevojave të individit duke u fokusuar kështu në aftësitë e tij e gjithashtu edhe në identifikimin e fushave kryesore dhe nevojat për intervenim dhe mbështetje. Pas një vlerësimi të realizuar të shërbimeve të ofruara nga Programi i RBB-së për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara në Kosovë, më 2018 ka nisur implementimi i modelit Bio-Psiko-Social, me mbështetje të zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Ofruesit e shërbimeve (fizioterapeut; punëtor social; ergoterapeut; logoped; psikolog; edukator) në Qendrat e RBB-së janë trajnuar në principet bazë të qasjes BPS si dhe kanë vazhduar mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke u bazuar në rekomandimet e qasjes BPS.

Kjo ka ndikuar dukshëm në mbështetjen holistike të zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar qasjen e shërbimeve si dhe teknikat e punës, rrjedhimisht në avancimin e shëndetit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS përmes implementimit të parimeve të qasjes BPS, vlerëson në baza tre-mujore të gjitha fushat e zhvillimit/funksionimit të fëmijëve, identifikon fushat kryesore dhe nevojat për intervenim, lidhë bashkëpunim me akterët kryesor në jetën e fëmijës, dhe koordinon me ta shërbimet dhe mbështetjen për fëmijën.



# SHËRBIMET

---


Ofrimi i shërbimeve në kuadër të Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi mbështetet në parimin për të kontribuar në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm të integritit dhe zhvillimit, i cili synon të garantojë për të gjithë mundësinë e përmbushjes së nevojave bazike si dhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.



Shërbimet që ofrohen nga QRBB përfshijnë një larmi programesh të hartuara për të përmbushur nevojat dhe interesat e përfituesve të shërbimit si dhe referimeve apo mbështetjes për të përdorur shërbimet e ofruara nga struktura të tjera të specializuara. Ekipet multidisciplinare, ekzistente në kuadër të Programit të RBB-së, përmes kartelave të vlerësimit, vlerësojnë fëmijët/të rriturit, në të gjitha fushat e zhvillimit me theks të veçantë ato të fushës së zhvillimit fizik, kognitiv, socializimit dhe shkathtësive të jetesës së pavarur. Nevojat e identifikuar reflektohen në Planet Individuale të Punës e të cilat vlerësohen në baza mujore.

## Në kuadër të RBB-së ofrohen:

- **Shërbimet e kujdesit ditor për fëmijë** të cilat kanë për qëllim të përforcojnë fushat si:  
Zhvillimin fizik; Zhvillimin njohës/kognitiv; Shëndetin; Shkathtësitë sociale; Parapërgatitje për shkollë; Shkathtësi të komunikimit; Shkathtësi ditore.
- **Shërbime për të rritur** të cilat kanë për qëllim të përforcojnë fushat si: Shkathtësitë sociale; Pavarësimin; Zhvillimin fizik; Zhvillimin njohës/kognitiv; Shëndetin; Trajnime; Punësim.



## Tutje, në kuadër të programit të RBB-së, ofrohen edhe:

- **Shërbime për pajisje ndihmëse** – vlerësimi, matja, përshtatja, trajnimi dhe këshillimi i përdoruesit të pajisjes ndihmëse;
- **Mbështetje për prindër/familjarë/kujdestarë** – programe për prindërim; këshillim dhe referim; Këshilla ligjore – për persona me aftësi të kufizuara, familjarë, prindër;
- **Burime informacioni** – për llojet dhe pasojat e aftësisë së kufizuar;
- **Mbledhje e shënimeve mbi personat me aftësi të kufizuara** (plotësimi i pyetësorëve) dhe regjistrimi i tyre në Bazën e të Dhënave.
- **Qasje të barabartë** – me **ZERO** tolerancë ndaj abuzimit apo diskriminimit.



*Ky doracak është hartuar në kuadër të projektit “Avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë”, i mbështetur nga zyra e UNICEF-it në Kosovë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e HANDIKOS-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e UNICEF-it.*

